



Nr.Prot. 045/B/11

**V E N D I M Nr. 122**

**Për  
Miratimin e Rregullores për  
'Operimin e Nyjës Shkëmbyese të Internetit KOSIX'**

Duke u bazuar në nenin 4 paragrafi (4) dhe nenin 6 paragrafi (1), të Ligjit mbi Telekomunikacionin Nr. 2002/07, të ndryshuar me ligjin Nr. 03/L-085, Bordi i Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit (ART) në përbërje,

- |                      |         |
|----------------------|---------|
| 1) z. Ekrem Hoxha    | Kryetar |
| 2) z. Besnik Berisha | Anëtar  |
| 3) z. Lulzim Kurtaj  | Anëtar  |
| 4) z. Nijazi Ademaj  | Anëtar  |

në mbledhjen e XXVI të bordit të mbajtur me datë; 06 Shtator, 2011 sipas procedurave të përcaktuara me dispozitat e ligjit bazë dhe Rregulloren e Brendshme të ART-së, shqyrtoi materialin e paraqitur nga Departamenti i Telekomunikacionit lidhur me 'Operimin e Nyjës Shkëmbyese të Internetit KOSIX'.

Nga diskutimi:

**VËREHET se;**

- Dokumenti për krijimin e nyjës shkëmbyese të internetit, i hartuar nga Departamenti i Telekomunikacionit është i bazuar në një nga objektivat që dalin nga plani i punës së ART-së për vitin 2011, plan ky i hartuar në harmoni me obligimet dhe prioritetet që dalin nga dokumenti i politikave të sektorit të telekomunikacionit dhe Plani i Veprimit të Partneritetit Evropian (PVPE);
- Përpara paraqitjes për miratim pranë Bordit Drejtues, draft rregullorja ka kaluar në procedurat adekuate të këshillimit publik duke respektuar të gjitha afatet dhe procedurat ligjore, si dhe është marrë edhe mendimi i zyrës ligjore pranë ART-së;
- Me themelimin e KOSIX, janë krijuar kushtet për shkëmbimin e thjeshtë të trafikut të internetit në mes të ofruesve të shërbimeve të internetit (tutje i njohur si - ISP) në Kosovë, duke mos ngarkuar rrjetet e treta, si dhe është bërë i mundur avancimi i sigurisë dhe privatësisë së komunikimeve të internetit duke mbajtur trafikun vendor 'lokal' brenda kufijve kombëtar, që është e një rëndësie të madhe kombëtare.

## ATËHERË:

Me qëllim të;

- të krijimit të kornizës ligjore për operimin e KOSIX, përfshirë këtu rregullat për anëtarësim, të drejtat dhe obligimet si dhe përcaktimin e nivelit të shërbimeve minimale;
- avancimit të sigurisë dhe privatësisë së komunikimeve të internetit duke e mbajtur trafikun vendor 'lokal' brenda kufijve kombëtar, ngritjes së cilësisë së shërbimeve, zvogëlimit të kostos për 'bit',
- të përpushjes së objektivit të ART-së, për të ndjekur parimet dhe principin e mbrojtjes së interesit të shfrytëzuesve,
- krijimit të kushteve të barabarta dhe një ambient të favorshëm për një konkurrencë të mirëfilltë për të gjithë ofruesit e shërbimeve të internetit,
- ofrimit të mundësive për projekte edukative dhe hulumtuese që ndihmojnë zhvillimin e komunitetit lokal të internetit dhe avancojnë tregun e shërbimeve të TIK,
- jetësimit të dispozitave të Ligjit të Telekomunikacionit, me qëllim të promovoj dhe lehtësoj ofrimin e shërbimeve të mjaftueshme dhe të kënaqshme vendore dhe ndërkombëtare të telekomunikacionit,
- realizimit të synimeve të parapara me dokumentin e Politikave të Sektorit të Telekomunikacionit, promovimi i nyjeve të përbashkëta në mes të ofruesve të shërbimeve të internetit.

Bordi i ART-së,

## VENDOSI

- I. Miratimin e Rregullores për 'Operimin e Nyjës Shkëmbyese të Internetit KOSIX'.
- II. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Bordi i ART-së.

Vendimi mbështetet në dispozitat e legjislacionin vijues, qoftë primar apo sekondar.

## BAZA LIGJORE;

- 1) Nenit 1, paragrafi (2); nenit 4, paragrafi (4); nenit 20 paragrafi (1); nenit 21 paragrafi (6) (d); të Ligjit të Telekomunikacionit Nr.2002/7, të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-085;
- 2) Pika 3.1.a.3, 3.1.3.a4 dhe 3.6.3(b) e dokumentit të Politikave të Sektorit të Telekomunikacionit të datës 13/06/2007, Nr. 195/07;
- 3) Vendimit Nr. 28 të datës; 26/08/2010 për Krijimin e Nyjës shkëmbyese të internetit (KOS-IXP) në Kosovë, Nr. 61/1/10;
- 4) Dokumentit Kornizë të datës 27/08/2010 për Krijimin e Nyjës shkëmbyese të internetit (Internet Exchange Point-IXP) në Kosovë;

Faqe 2 nga 3

Adresa: Qyteza Pejton, rr.Pashko Vasa nr. 12, 10 000 Prishtinë-Kosovë

Tel: +381 38 212-345; Fax: +381 38 212 399;

E-mail: [info@art-ks.org](mailto:info@art-ks.org); web-site: [www.art-ks.org](http://www.art-ks.org)



- 5) Urdhëresën për vendosjen e kushteve shtesë për licencat dhe autorizimet për ofruesit e shërbimeve të internetit, datë 26/08/2010, Nr. 64/1/10;
- 6) Memorandumin e Mirëkuptimit e arritur në mes Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit (tutje i njohur si ART) dhe Universitetit të Prishtinës më datë 19/07/2010, Nr. 272/2/10;
- 7) Planit të Veprimit të Partneritetit Evropian (PVPE).
- 8) Neneve 20 dhe 22 të Rregullores së brendshme të ART-së

### **Këshilla Juridike**

Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk lejohet ankesa.

Ky vendim i nënshtrohet çfarëdo shqyrtimi përmes procedurave administrative gjyqësore të parapara me ligjet në fuqi.

### **Vërtetim**

Më këtë vendim konfirmohet se Bordi i ART-së ka vendosur në pajtueshmëri me rregulloret dhe ligjet e aplikueshme në Kosovë, dhe në pajtueshmëri me rregullat e procedurës së ART-së.

Prishtinë, 13 / 09 / 2011

**Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit**

**Ekrem Hoxha**  
**Kryetar i Bordit**



Besnik Berisha, Anëtar i Bordit  
Nijazi Ademaj, Anëtar i Bordit

### **Aktvendimi i dërgohet:**

- Operatorëve të licencuar me ISP licenca/ autorizime
- Rektorit të Universitetit të Prishtinës dhe Dekanatit të FIEK
- Departamentit të Telekomunikacionit
- Arkivit të ART-së